



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHBA-ja: NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE SYNON NJOHJEN RECIPROKE KOSOVË - SERBI

FAQE 4-5



Shtetet e Bashkuara njoftuan se e mbështetin propozimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe u bënë thirrje liderëve të të dyja vendeve që të jenë konstruktivë. "Serbia dhe Kosova duhet të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse përmes dialogut. Ne besojmë se marrëdhëniet e normalizuara ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në fund të fundit duhet ta synojnë njohjen reciproke", është thënë në përgjigjen me shkrim të DASH-it

AKTUALE



STUHI TË RREZIKSHME DIMRI PËRFSHIJNË SHTETET E BASHKUARA F.2

KOSOVA U BËNË THIRRJE SHTETEVE TË RAJONIT QË TA RATIFIKOJNË MARRËVESHJEN PËR LËVIZJE TË LIRË F.6

RASTI I MARTIN BERISHAJT, TAHIRI: KRYELAJM NË SLOVENI, OSMANI, KURTI E GËRVALLA PO E MBROJNË F.7

EKONOMI



HOTI, MINISTRIT PECIT: EFEKTET E PUNËS I KE ZERO, PRODHIMI VENDOR KA RËNË F.6

KOSOVA DHE MALI I ZI E SHOHIN TË RËNDËSISHËM NDËRTIMIN E RRUGËVE PEJË - ROZHAJË DHE DEÇAN - PLAVË F.8

SPORT



LLAPI PËRGJIGJET PËR DYSHIMET PËR KURDISJE: NUK KEMI SHOQËSIM RRETH PRETENDIMEVE TË PABAZA DHE TENDENCIOZE F.10

TRE REAGIME TË MUHAMET MAVRAJT PËR ZHVILLIMET E JAVËS NË KOSOVË

DISA HISTORIANË E SHKRUAJNË HISTORINË, NDOJËRI E KRIJON ATË

FAQE 5

Publicisti Muhamet Mavraj ka reaguar gjatë javës për tri ngjarje të ndryshme. E para ka të bëjë me kremtimin e 15 vjetorit të pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2023 në të cilin u injoruan krerët krijues të shtetit të Kosovës; E dyta me bastisjen e ish këshilltarit të Thaçit, Adil Behramajt; E treta përkujton njëvjetorin e luftës në Ukrainë. Këto

në fakt janë postime në profilin personal të Mavrajt në Facebook të cilat janë komentuar dhe shpërndarë në masë të madhe nëpër këtë rrjet nga ndjekësit e Mavrajt.



UKRAINA SHËNON PËRVJETORIN E LUFTËS

FAQE 3



BE-ja I JEP KOSOVËS 75 MILIONË EURO NDIHMË PËR PËRBALLJE ME KRIZËN ENERGETIKE

FAQE 8



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fac: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja ofron edhe dy miliardë dollarë ndihmë për Ukrainën

UASHINGTON, 24 SHKURT - Shtetet e Bashkuara do t'i ofrojnë Ukrainës një ndihmë shtesë prej 2 miliardë dollarësh për sigurinë, tha të enjten këshilltari për siguri kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, Jake Sullivan. "Ne do të vazhdojmë të shikojmë se çfarë është e nevojshme dhe do të sigurohemi që të ofrojmë atë që i nevojitet Ukrainës për të pasur sukses në fushëbetë", tha Sullivan.

Ai tha se vendet e G7-s, që përbëhen nga Kanadaja, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të shpallin të

premtën një raund të ri sanksionesh që do të përfshijnë edhe vendet që po përpiqen të ofrojnë ndihmë për Rusinë. "Do ta shihni me kalimin e kohës ndryshkjen e vazhdueshme të kualitetit dhe kapacitetit të ekonomisë ruse, përkundër faktit që Putini nxiton të shpenzojë para në përpjekje për ta ngjallur atë", tha Sullivan.

I pyetur në lidhje me kërkesën e Ukrainës për avionët luftarakë F-16, Sullivan tha nga këndvështrimi i Uashingtonit, "F-16 nuk janë një çështje për luftën afatshkurtë; F-16 kanë të bëjnë me mbrojtjen afatgjatë të Ukrainës".

Më 20 shkurt, gjatë një vizite të paparalajmëruar në Ukrainë, presidenti amerikan Joe Biden tha se ShBA-ja po përgatit një dërgesë të re të "pajisjeve kritike" për Ukrainën, e cila, siç tha, do të përfshijë municione artilerie dhe radarë të mbikëqyrjes ajrore. Biden, gjithashtu, paralajmëroi edhe sanksione të reja kundër shtetit rus.

ShBA-ja është ndër ofrueset më të mëdha të ndihmave për ushtrinë ukrainase. Që nga fillimi i pushtimit rus, më 24 shkurt të vitit të kaluar, Uashingtoni i ka dërguar pajisje mbrojtëse dhe logjistike në vlerë prej dhjetëra miliarda dollarësh.



Stuhi të rrezikshme dimri përfshijnë Shtetet e Bashkuara

UASHINGTON, 24 SHKURT - Një stuhi dimëror me borë dhe erëra të forta goditi Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga bregu në breg, paralizoi rrugët dhe la në errësi rreth një milion shtëpi dhe biznese. Shërbimi Kombëtar i Motit paralajmëroi për një "stuhi të ftohtë dhe të rrezikshme dimri" deri të shtunën. Deri në 1.5 metra borë mund të bjerë në disa male pranë Los Anxhelosit, duke përbërë një rrezik për ortekët.

Si pasojë e stuhisë u mbyllën autostradat ndërshtetërore nga Arizona në Uajoming, shoferët u bllokuan në makina dhe pati



ndërprerje të energjisë elektrike për qindra mijëra qytetarë dhe familje.

Stuhia e rëndë në veri të ShBA-

së mbylli shkollat, zyrat dhe gjithë legjislaturën e Minesotës. Sipas shërbimit të gjurmimit, FlightAware, për shkak të motit

të lig, u anuluan më shumë se 1 600 fluturime në gjithë vendin. Mbi 5 000 fluturime të tjera u vonuan.

Në Uajoming ekipet e shpëtimit u përpoqën të arrinin te njerëzit e bllokuar në automjete, por erërat e forta dhe bora krijuan një "situatë pothuajse të pamundur" për ta, tha Jeremy Beck, shef i patrullës së autostradës së Uajoming. Erërat e fuqishme ishin problemi më i madh në Kaliforni, duke rrëzuar pemë dhe duke shkatërruar linjat elektrike. Deri të mërkurën në mbrëmje u raportua se më shumë se 65 000 familje në këtë

shtet ishin pa energji elektrike. Për herë të parë që nga viti 1989, një paralajmërim për stuhi u lëshua për malet e Los Anxhelosit, si dhe në Ventura e Santa Barbara.

Më shumë se 8 000 persona mbetën pa energji elektrike në Arizona.

Në veri të ShBA-së, një rajon i mësuar me stuhi të tilla, temperaturat mund të bien deri në minus 32 gradë celsius.

Raportohet se më shumë se 192 000 qytetarë ose familje në Miçigan dhe gati 89 000 në Illinois ishin pa energji elektrike të mërkurën në mbrëmje.

Scholz: Kërkesa e Ukrainës për avionë luftarakë aktualisht nuk ka kuptim

BLERIN, 24 SHKURT - Pyetja nëse Ukraina duhet të furnizohet me avionë luftarakë "aktualisht nuk ka kuptim", tha kancelari gjerman Olaf Scholz, në një intervistë ku ai u pyet të adresonte thirrjet në rritje për fuqitë perëndimore që t'i japin Kievit avionë.

Në intervistën për televizionin publik gjerman, Scholz, që më herët është përbullur me kritika për shkak të zvarritjes së vendimit për ta lejuar dërgimin e tankeve në Ukrainë, tha se vështirësitë e shteteve të tjera për përmbytjen e kërkesave të Ukrainës justifikojnë vendimin e tij që të jetë në linjë të njëjtë me ta.

Më herët gjatë këtij muaji, Gjermania u pajtua që të dërgojë dhe t'i lejojë edhe

shtetet e tjera që të dërgojnë tanke të rënda të prodhimit gjerman në Ukrainë, në mënyrë që forcat e Kievit të kryejnë ofensivë kundër forcave ruse në lindje të shtetit. Pavarësisht prej këtij vendimi, dërgesat e tankeve kanë qenë të ngadalshme për shkak se shtetet që janë zotuar se do të dërgojnë tanke kanë numër të kufizuar të tyre. "Ndoshta ky është tregues se pse është e rëndësishme të koordinohemi me njëri-tjetrin, me Shtetet e Bashkuara për shembull, dhe t'i përgatitim këto vendime në mënyrë të kujdesshme që ato të funksionojnë", tha ai.

Ukraina tani po kërkon avionë luftarakë, edhe pse Gjermania nuk ka asnjë avion F-16 që janë përmendur nga Kievi.



Duke folur një ditë para përvjetorit të parë të nisjes së pushtimit rus të Ukrainës, Scholz tha se ka frikë se konflikti do të shndërrohet "në një luftë të gjatë", por shtoi se Gjermania dhe Perëndimi do ta mbështetin Ukrainën për aq sa të jetë e nevojshme. Sipas tij, presidenti rus Vladimir Putin eventualisht do të duhet ta kuptojë se qëllimet e luftës së tij janë të paarrtshme. "Janë vetëm pak shtete që janë në anën e Rusisë", tha ai.

Një ditë para përvjetorit të parë të nisjes së pushtimit, presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se shteti i tij do të dalë triumfues nga kjo luftë dhe u zotua se do t'i mbajë përgjegjës të gjithë ata që kanë sjellë luftën në territorin ukrainas.

Ukraina shënon përvjetorin e luftës

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, u zotua për fitore në vitin 2023 derisa ky shtet ka shënuar të premtën përvjetorin e parë të zymtë të agresionit rus, që ai e quajti “dita më e gjatë e jetës sonë”

KIEV, 24 SHKURT - Lufta në Ukrainë hyri në vitin e saj të dytë të premtën, derisa presidenti Volodymyr Zelensky u zotua se Ukraina “do t’i mposhtë të gjithë”, dhe se liderët e vendeve aleate do të vendosin sanksione të reja ndaj Ruisë dhe shteteve të tjera që mbështetin luftën e saj. Përmes një videomesazhi, Zelensky tha: “Ne jemi të fortë. Jemi gati për çdo gjë. Do t’i mposhtim të gjithë. Kështu filloi më 24 shkurt 2022”, tha ai, duke u ulur pas një tavoline dhe duke kujtuar momentin kur iu drejtua ukrainasve një vit më parë. “Dita më e gjatë e jetës sonë. Dita më e vështirë në historinë tonë moderne. Ne u zgjuam herët dhe nuk fjetëm më që atëherë”. Zelensky e përshkroi vitin 2022 si një vit qëndrueshmërie, guximi,

Alarmet për sulme ajrore nuk u dëgjuan gjatë natës në kryeqytetin Kiev. Megjithatë, qeveria rekomandoi që shkollat ta zhvendosin mësimin në internet dhe punonjësit të zyrave iu kërkua të punojnë nga shtëpia. Homazhet për qëndrueshmërinë e Ukrainës erdhën edhe nga vendet evropiane. Kulla Eifel në Paris ishte ndër monumentet e ndriçuara me ngjyrat e Ukrainës - të verdhë dhe kaltër. Një vit më pas, shifrat e viktimave janë të mëdha nga të dyja palët, me vlerësimet perëndimore që flasin për qindra mijëra të vrarë dhe të plagosur. Lufta në Ukrainë ka hyrë në vitin e saj të dytë të premtën. Pushtimi rus i Ukrainës, që nisi



Prishtina solidarizohet me Ukrainën në përvjetorin e parë të pushtimit

Në sheshet kryesore të Prishtinës janë vendosur flamuj kombëtarë të Ukrainës dhe mesazhe në mbështetje të saj, në prag të njëvjetorit të nisjes së pushtimit rus të Ukrainës. Kosova u është bashkuar shteteve perëndimore duke dënuar dhe vendosur sanksione ndaj Ruisë për shkak të pushtimit të paprovokuar të fqinjës së saj. Në përvjetorin e nisjes së luftës në Ukrainë, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është shprehur e sigurt në fitoren e Ukrainës, teksa ka thënë se “lufta e tyre është lufta jonë”. “Triumfi i demokracisë, drejtësisë dhe lirisë në Ukrainë do të jetë një fitore për demokracitë kudo”, thuhet në postimin e Osmanit në “Twitter”.

“Kjo luftë e ka bashkuar botën demokratike, mbi të gjitha ka dëshmuar se shpirti i popullit ukrainas është i pathyeshëm. Siç e dinë qytetarët e Kosovës shumë mirë, brutaliteti dhe agresioni nuk mund ta pengojnë vullnetin e një populli për të qenë i lirë”, thuhet në deklaratën e Osmanit. Më tutje, Osmani shtoi se Kosova do të qëndrojë gjithmonë përkrah demokracive të botës përballë “tiranive dhe hegjemonive”. “Sepse ne e dimë se lufta e tyre është lufta jonë dhe se triumfi i demokracisë, drejtësisë dhe lirisë në Ukrainë do të jetë fitore për demokracitë kudo në botë”, thuhet në deklaratën e Osmanit.

Përveçse i është bashkuar ShBA-së dhe BE-së për vendosjen e sanksioneve ndaj Ruisë, Kosova edhe ka strehuar disa gazetarë ukrainas pas



nisjes së pushtimit rus të Ukrainës më 24 shkurt 2022. Përvjetori i parë i luftës në Ukrainë është shënuar edhe në një seancë solemne të mbajtur në Kuvendin Komunal të Prishtinës, ku morën pjesë edhe ambasadori i ShBA-së, Jeff Hovenier, dhe ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Sznunuyog. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeff Hovenier, u shpreh falënderues ndaj popullit të Kosovës për përkrahjen e treguar për Ukrainën në luftën kundër Ruisë, në një fjalim gjatë seancës solemne të Kuvendit Komunal të Prishtinës në përvjetorin e nisjes së luftës në Ukrainë. “Populli i Kosovës është pjesë integrale e këtij reagimi të unifikuar nga kombet demokratike. Ju u keni ofruar strehim ukrainasve që ikën nga lufta, keni qëndruar përkrah nesh dhe BE-së në vendosjen e sanksioneve”, tha Hovenier. Ai, gjithashtu, shtoi se ShBA-ja dhe partnerët e saj do të vazhdojnë ta mbështetin

Ukrainën siç kanë bërë deri tani, teksa tha se presidenti i Ruisë, Vladimir Putin, ka dështuar në tentimin e tij për ta përçarë bllokun e NATO-s. Edhe ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Sznunuyog, u shpreh mirënjohës që Kosova u është bashkuar shteteve perëndimore për vendosjen e sanksioneve ndaj Ruisë, teksa tha se pushtimi i Ukrainës ka prekur gjithë botën. “Edhe pse lufta kishte filluar dhe ishte jashtë kufijve tanë, pasojat janë parë dhe janë ndier në të gjithë botën, përfshirë këtu edhe Ballkanin Perëndimor, në veçanti Kosovën”, tha Sznunuyog. Të pranishmëve në Kuvendin Komunal të Prishtinës iu drejtua edhe Luidmyla Makei, përfaqësuese e gazetarëve ukrainas të strehuar në Kosovë. “Dua t’ju tregoj sa më shumë për heroizmin e ushtarëve tanë, mijëra civilëve të vrarë dhe qyteteve të shkatërruara dhe sakrificat e përditshme që i bën vendi im. Unë, thjesht, dua t’ju them faleminderit!”, tha Luidmyla.



dhimbjeje dhe uniteti. “Përfundimi i saj kryesor është se ne kemi mbijetuar. Ne nuk u mundëm. Dhe ne do të bëjmë gjithçka për të fituar këtë vit”, tha ai. Ukrainasit organizuan takim përkujtimor, ndezje qirinsh dhe aktivitete të tjera për dhjetëra mijëra qytetarë të tyre që humbën jetën - një numër që rritet gjatë gjithë kohës teksa luftimet janë shtuar, në veçanti në lindje të vendit. Në përvjetorin e parë të nisjes së pushtimit më 24 shkurt, ushtria ukrainase tha se pret që atë ditë Rusia të kryejë sulme ajrore.

më 24 shkurt 2022, është një prej konflikteve më vdekjeprurëse në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Po ashtu, ka shkakuar konfrontimin më të madh midis Moskës dhe Perëndimit që prej krizës së raketave kubane të vitit 1962, kur Bashkimi Sovjetik dhe ShBA-ja ishin afër një lufte bërthamore. Presidenti rus, Vladimir Putin, e ka quajtur luftën si “operacion special ushtarak” për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra.

ShBA-ja: Normalizimi i marrëdhënieve synon njohjen reciproke Kosovë - Serbi

Shtetet e Bashkuara njoftuan se e mbështetin propozimin e Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe u bënë thirrje liderëve të të dyja vendeve që të jenë konstruktivë. “Serbia dhe Kosova duhet të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse përmes dialogut. Ne besojmë se marrëdhëniet e normalizuara ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në fund të fundit duhet ta synojnë njohjen reciproke”, është thënë në përgjigjen me shkrim të DASH-it

PRISHTINË, 24 SHKURT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë njoftuar se e mbështetin fuqishëm propozimin e Bashkimit Evropian (BE) për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “Ne presim që të dy liderët t’i qasen takimit në frymën konstruktive të nevojshme për të ecur përpara në përputhje me të”, është thënë në reagimin e Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) për “Zërin e Amerikës” në prag të raundit të ri të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian do të mbahet të hënën në Bruksel.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, siç ka raportuar më herët i dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajçak, përveç deklaratës zyrtare të pranimit, duhet t’i shqyrtojnë edhe detajet e zbatimit të propozimit evropian.

Departamenti i Shtetit i ka treguar “Zërit të Amerikës” në gjuhën serbokroate se është e rëndësishme që Serbia dhe Kosova t’i përdorin bisedimet për ta shprehur përkushtimin e tyre për një të ardhme paqësore të rajonit. “Serbia dhe Kosova duhet të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse përmes dialogut. Ne besojmë se marrëdhëniet e normalizuara ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në fund të fundit duhet ta synojnë njohjen reciproke. Progresi në dialog do ta hapë derën e integritimit evropian dhe është i një rëndësie thelbësore për sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor”, është thënë në përgjigjen me shkrim të DASH-it.

I pyetur nëse mund të pritet një

përparim apo edhe një pikë kthese pas raundit të ardhshëm të bisedimeve në Bruksel, Departamenti i Shtetit është përgjigjur se është inkurajuese që Serbia dhe Kosova e kanë pranuar në parim propozimin e Bashkimit Evropian. “Zyrtarët e Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian theksuan mundësitë e propozimit të Bashkimit Evropian dhe theksuan rëndësinë e përparimit të shpejtë - për ta shmangur rrezikun e përshkallëzimeve të mëtejshme. Ne inkurajojmë fuqishëm serbët e Kosovës që të kthehen sa më shpejt në institucionet e Kosovës në mënyrë që të përmirësohen siguria dhe stabiliteti për të gjithë qytetarët. Ne e inkurajojmë Qeverinë e Kosovës të sigurojë kushte për serbët e kualifikuar të Kosovës që ta bëjnë këtë pa vonesë. Marrëveshjet e Brukselit parashikojnë integritimin e serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës. Ne i mbështetim plotësisht ato marrëveshje dhe vazhdimin e zbatimit të tyre”, është thënë në përgjigjen e DASH-it lidhur me këtë çështje.

Gjithashtu, një çështje shumë e rëndësishme që ngadalëson dukshëm mundësitë e dialogut mes dy palëve është zbatimi i marrëveshjes në kuadër të themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Bëhet fjalë për organizimin e pushteteve dhe strukturës ende të panjohura dhe të papërcaktuara, të rëna dakord një dekadë më parë - në Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013. Mirëpo në vitin 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi se disa dispozita të asaj marrëveshjeje ishin



jokushtetuese dhe autoritetet e Kosovës, për momentin, nuk tregojnë gatishmëri për ta zbatuar atë - duke e kontestuar në masën më të madhe për shkak të karakterit njëetnik. Në muajt e fundit Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë insistuar që autoritetet e Kosovës ta zbatojnë atë dispozitë të marrëveshjes sa më shpejt të jetë e mundur, gjë që është konfirmuar edhe një herë nga Departamenti i Shtetit: “Kosova dhe Serbia duhet t’i zbatojnë marrëveshjet që kanë nënshkruar përmes procesit të dialogut, duke përfshirë përparimin në themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe”.

Iniciativa e përforcuar diplomatike e aleatëve perëndimorë kushtuar shtimit të dialogut ndërmjet Serbisë dhe Kosovës nisi në vitin e pushtimit rus të Ukrainës. Lufta e pajustificuar ruse, siç e quajnë ata, ka iniciuar frikën për mundësinë e përhapjes së konfliktit apo destabilizimit të zonave që janë në sferën e ndikimit rus. Një prej tyre është Serbia, që e ka dënuar agresionin rus, por edhe një nga vendet e pakta evropiane që nuk ka vendosur sanksione ndaj Rusisë.

Në skenën ndërkombëtare Rusia mbështet politikën e Serbisë, duke u bazuar në qëndrimin se Kosova është

pjesë e patjetërsueshme e saj, ndonëse e përdor shpalljen e pavarësisë së ish-krajinës Jugosllave si argument për aneksimin e territoreve ukrainase - gjë që shumica e vendeve të botës e konsiderojnë shkelje flagrante të së drejtës ndërkombëtare.

Në përgjigje të pyetjes se a e sheh marrëveshjen e palëve për propozimin evropian si mjet për neutralizimin e ndikimit të Rusisë në Serbi, Departamenti i Shtetit thekson se dialogu me Kosovën është i rëndësishëm për stabilitet. “Progresi drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës përmes dialogut, me ndërmjetësimin e BE-së, është ende shumë i rëndësishëm për stabilitetin rajonal dhe evropian në një kohë kur po përballlemi me agresionin rus në Ukrainë dhe me kriza në mbarë Evropën të shkaktuara nga dhuna brutale e pushtimit të pajustificuar të Putinit”, kanë theksuar nga Departamenti i Shtetit.

Refuzimi eventual i dokumentit, versioni zyrtar i të cilit ende nuk dihet për publikun, do të nënkuptonte një sinjal negativ nga njëra apo të dyja palët se nuk janë të gatshme të ecin më shpejt në rrugën evropiane, është vlerësimi i të dërguarit të BE-së, Miroslav Lajçak, për mediet serbe. Ndryshe nga ai, Departamenti i Shtetit nuk ka

folur për pasojat e mundshme nëse Serbia dhe Kosova refuzojnë apo humbasin mundësinë që u është ofruar. “Është më e rëndësishme të flasim për mundësitë: propozimi paraqet mundësi për qytetarët e Serbisë dhe Kosovës për ta përmirësuar sigurinë dhe stabilitetin e rajonit më të gjerë të Ballkanit Perëndimor në një kohë kur Evropa po përballlet me krizën më të rëndë që nga Lufta e Dytë Botërore. Siç është treguar tashmë nga Bashkimi Evropian, pranimi i marrëveshjes do ta përshpejtojë përparimin e të dy vendeve drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ai, gjithashtu, do t’i avancojë qëllimet tona kryesore për rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë arritjen e paqes, stabilitetit dhe përparimit të të gjithë popujve”, kanë thënë nga Departamenti i Shtetit.

Siç ka njoftuar Shërbimi Evropian për Punë të Jashtme (EEAS), shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell dhe i dërguari për dialog, Miroslav Lajçak, fillimisht do të kenë takime të ndara me Albin Kurtin dhe Aleksandër Vuçiqin, pas së cilës do të vijojë takimi i përbashkët. Bisedimet do të përqendrohen në propozimin franko-gjerman ose evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Çitaku: Plani franko-gjerman është produkt i negociimit të kryeministrit

PRISHTINË, 24 SHKURT - Nënkrjetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka theksuar se plani franko-gjerman nuk ka pikur nga qielli. “Ai është produkt i negociimit të kryeministrit tash e dy vjet”, ka shkruar

Çitaku në “Facebook”. Ajo ka theksuar se kryeministri Kurti ka arritur suksesshëm që dialogun Kosovë - Serbi nga marrëveshja politike ta kthejë në problem të sigurisë. “Të hënën kryeministri Kurti do ta nënshkruajë marrëveshjen për armëpushim, jo

marrëveshjen finale, me njohjen reciproke në qendër. Të hënën kryeministri Kurti do ta nënshkruajë zotimin e tij për ta vazhduar dialogun edhe për një dekadë”, ka shkruar Çitaku, duke shtuar se të hënën kryeministri Kurti do ta nënshkruajë asociacionin,

apo Zajednicën siç e quante dikur. “Të hënën kryeministri Kurti do ta nënshkruajë zotimin për t’i dhënë Kishës Ortodokse Serbe status politik. Kaq për gjenialitetin e kryenegociatorit Kurti”, ka shkruar nënkryetarja e PDK-së.



TRE REAGIME TË MUHAMET MAVRAJ TË ZHVILLIMET E JAVËS NË KOSOVË

Disa historianë e shkruajnë historinë, ndonjëri e krijon atë



Publicisti Muhamet Mavraj ka reaguar gjatë javës për tri ngjarje të ndryshme. E para ka të bëjë me kremtimin e 15 vjetorit të pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2023 në të cilin u injoruan krerët krijues të shtetit të Kosovës; E dyta me bastisjen e ish këshilltarit të Thaçit, Adil Behramaj; E treta përkujton njëvjetorin e luftës në Ukrainë. Këto në fakt janë postime në profilin personal të Mavrajt në Facebook të cilat janë komentuar dhe shpërndarë në masë të madhe nëpër këtë rrjet nga ndjekësit e Mavrajt.

18 shkurt 2023

Iku 17 shkurti. Pas veprimeve flagrante të anetarëve të kllubit (stanit) në çdo solemnitet të djeshëm shtetëror, duke injoruar me fanatizem emrat krijues të historisë së Kosovës, vecmas të 17 shkurtit 2008 e të cilët janë në Hage, po i bij shkurt me këtë video 20 sekondeshe.

MAVRAJ : Ai ka studiuar ketu, në këtë fakultet, prapa shpines tone ketu ku jemi, për historian. Kosova i ka disa historianë që shkruajnë historinë, por fare pak historianë që e krijojnë atë. Ndër këta, kryesori për krijimin e historisë së re të Kosovës, është

Hashim Thaçi pa asnjë dyshim. Jakup Krasniqi është në këtë grup.

PS

Eshtë vone për praktikën jugosllave-staliniste, për zhbirjen e zhberjen e të kaluarës, por mire që nuk po i fshehin.

22 shkurt 2023

Ndjej neveri ndaj perndjekjes qyqare të Gjykatës Speciale kundër Adil BEHRAMAJT. E di që është presion kundër atyre që janë në Hage. Eshtë gjykatë deshtake, mjerisht e tredhur

naivisht në drejtim të interesave joperendimore, thjesht ruse-serbe. Koha do të flase se Evropa po harxhon para për ato interesa. Adil Behramaj, përtej detyrave që i ka kryer me nder dhe përtej të qenmit editor i mediumit Demokracia.com, është një nga autorët me të mprehte analitike në skenën publike. Eshtë brutalisht i sakte! Solidarizohem me Behramajn!

24 shkurt 2023

Nderime kombit ukrainas në përvjetorin e rezistencës mbinjerezore përballë mizorive

ruse!

Rusia e forcuar për 30 vjet nga investimet evropiane, sidomos gjermane, dermoi Gjeorgjinë e Ukrainën dhe destabilizoi mbare botën. Nga Karta e OKB-se ka ngelur vetëm kopertina e saj. Mbeshtetja e Ukrainës në mikun amerikan është jetike për ekzistencën e saj. Pa të zhduket. (Një përkujtim i madh ky për bolshevikët tane). Diktatorët dhe mistreca bazohen në propagandë, mashtrim dhe trushperlarje. Historia ka treguar se secili nga ata në fund merr dajak të forte dhe mbaron në koshin e plehrave.

Komandanti i KFOR-it: Njësia Speciale mund të shkojë në veri pa miratimin tonë, FSK-ja jo

PRISHTINË, 24 SHKURT - Komandanti i KFOR-it, Angelo Mikele Ristuccia, e ka përsëritur faktin se misioni që ai e drejton nuk ka asnjë provë për praninë e grupit ushtarak privat rus Wagner në Kosovë. E ndërsa ka thënë se Forcat e Sigurisë së Kosovës nuk mund të shkojnë në veri pa miratimin e tij dhe se asnjëherë nuk kanë bërë një kërkesë të tillë deri më tani, Ristuccia ka theksuar se forcat speciale të policisë nuk kanë nevojë për leje për të qëndruar në veri, duke kujtuar marrëveshjen në Bruksel.

“Serbia ka nënshkruar dhe ka përcaktuar qartë Policinë e Kosovës si e vetmja kompetente për detyrat e zbatimit të ligjit dhe policisë. Pavarësisht nga llojet e policisë, si është organizuar policia, çfarëdo qofshin ato - njësitet ROSU, njësitë speciale, ato janë përgjegjëse për luftimin e krimit, grupeve të organizuara kriminale. Nuk ka kufizime për Policinë e Kosovës kur bëhet fjalë për kryerjen e detyrave të tilla në mbarë Kosovën”, tha Ristuccia për Kossev. Ai e vlerëson situatën aktuale në

Kosovë si të ndjeshme dhe të paqëndrueshme, por ende paqësore dhe dukshëm më të mirë sesa ishte në dhjetor. “Mund të themi se situata tani është shumë më e mirë sesa ishte në dhjetor. Megjithatë, ka një sërë çështjesh që na shqetësojnë, siç është, për shembull, vakuumi i rrezikshëm që u krijua në veri pasi serbët nga Kosova dhanë dorëheqje nga institucionet”, shprehet Ristuccia. Ky vakum është shumë i rrezikshëm, sidomos nga pikëpamja e sigurisë, tha komandanti i KFOR-it.



Verifikimi i sigurisë, së shpejti nuk do të bëhet më nga AKI-ja

PRISHTINË, 24 SHKURT - Një ligj i një rëndësie të veçantë për interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës ka kaluar në lexim të parë pa shumë zhurmë në shtator të vitit të kaluar në Kuvend.

Pavarësisht prej rëndësisë, debat për të nuk kishte në Kuvend, pasi opozita nuk kishte qenë e pranishme. Bëhet fjalë për Projektligjin për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, që i formuluar nga Qeveria e Kosovës, po synon të dalë nga ombrella e Agjencisë e Kosovës për Inteligjencë. Në kuadër të tij parashihet edhe themelimi i një Agjencie për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.

AMIK, siç do të njihet në shkurtesë kjo agjenci, drejtori i saj do t'i raportojë drejtpërdrejt kryeministrit. Një gjë të tillë po e kundërshton fuqishëm Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Hisen Berisha, që është edhe pjesë e Komisionit për Siguri, po e konsideron kapje edhe të një mekanizmi nga ekzekutivi për çka thotë se Kosovës po i instalohet komunizmi. "Ka tendenca që në kuadër të tij ta kenë edhe segmentin që do të merret edhe me dhënien e certifikatave të sigurisë së pjesëtarëve apo përfaqësuesve publikë të shtetit. Kjo është tendencë tipike komuniste, që e ka pasur Partia e Punës e Shqipërisë. Unë besoj se këtu do të reagoj edhe shoqëria civile. Edhe institucionet e drejtësisë, deri te Gjykata Kushtetuese, por edhe mekanizmat ndërkombëtarë", ka thënë Berisha.

Ai këmbëngul që i njëjti mekanizëm duhet të vazhdojë të jetë kompetencë e AKI-së. "Si ka logjikë që një agjenci që certifikon sigurinë e personaliteteve të jetë brenda zyrës së kryeministrit brenda qeverisë. Kush do ta certifikojë së pari këtë kryeministër?", ka thënë Berisha. Por më i qetë në këtë drejtim shprehet kryetari i Komisionit të



Sigurisë, deputeti i AAK-së, Bekë Berisha. Qeveria ka tendencë për shtrirje të gjerë autoriteti dhe, sipas tij, por për këtë ligj ai thotë se nuk e kanë të lehtë keqpërdorimin me të. "Këto janë shqetësime të popullit sepse në qeverisje është një parti politike që synon të kapë gjithçka, mirëpo nuk duhet frikësuar. Qeveritë ndërrohen,

ligjet janë për të mirën e qytetarëve, ligjet për sigurinë nuk mund të keqpërdoren ashtu siç po dyshohet. Nuk ka ndonjë rrezik", ka deklaruar Berisha.

Nga ana tjetër, Enver Dugolli, gjithashtu pjesë e Komisionit të Sigurisë nga shumica, po befasonet nga disa prej komenteve të opozitës pasi, sipas tij, në

komision unanimitisht ishin shprehur për, përderisa e mohon kategorikisht mundësinë e ndërhyrjes së qeverisë në këtë departament. "Që në fillim kur është themeluar ky departament ka qenë gabim që është vendosur në kuadër të AKI-së për shkak se është konflikt interesi. Askund, në asnjë shtet, në asnjë rrethanë, në asnjë moment nuk e gjeni të bashkangjitur Agjencinë e Inteligjencës me Agjencinë për Informacionin e Klasifikuar sepse janë të ndara, sepse natyra e punës është e tillë", ka thënë deputeti i LV-së, Enver Dugolli.

Sipas këtij projektligji, niveli i klasifikimit të informacionit do të jetë i renditur në "tepër sekret", "sekret", "konfidencial" dhe "i kufizuar". Informacioni do të mbetet i klasifikuar për aq kohë sa e kërkon interesi i sigurisë së Kosovës. Në Projektligj është paraparë edhe asgjësimi dhe shkatërrimi i informacionit të klasifikuar.

Kosova u bënë thirrje shteteve të rajonit që ta ratifikojnë marrëveshjen për lëvizje të lirë

PRISHTINË, 24 SHKURT - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, i ka bërë thirrje Bosnjë-Hercegovinës dhe shteteve të tjera të rajonit që ta ratifikojnë sa më shpejt marrëveshjen për lëvizjen e lirë me letërnjoftime në Ballkanin Perëndimor. "Kosova me ratifikimin që ka bërë dje, ka treguar përkushtimin, sinjeritetin e angazhimit të saj ndaj këtyre marrëveshjeve. Dhe presim që sa më shpejt ky shembull të ndiqet edhe nga vendet e tjera anëtare", ka thënë Bislimi në konferencë për medie gjatë nënshkrimit të marrëveshjes financiare në mes të



Qeverisë së Kosovës dhe Kjo marrëveshje, të cilën Kuvendi i Kosovës e ratifikoi të enjten, më 23

shkurt, është një prej tri marrëveshjeve të arritura vitin e kaluar në Berlin në kuadër të Procesit të Berlinit.

Bashkimi Evropian e vlerësoi ratifikimin e marrëveshjes nga Kuvendi i Kosovës, me shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, "një hap të rëndësishëm". "Ky është një hap i rëndësishëm, sepse partitë politike në Kosovë janë të bashkuara për rrugën evropiane", tha Szunyog.

Edhe pse është pritur që kjo marrëveshje të votohet në të njëjtën ditë edhe nga Bosnjë-Hercegovina, Këshilli i Ministrave i

këtij vendi e ka shtyrë votimin. Bosnjë-Hercegovina nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe qytetarët e të dyja shteteve duhet të pajisen me vizë nëse duan të udhëtojnë në shtetet përkatëse. Pas hyrjes në fuqi, marrëveshja do të mundësojë lëvizjen pa viza të qytetarëve nga Kosova dhe Bosnja.

Shtetet e Ballkanit Perëndimor vitin e kaluar kanë arritur një marrëveshje për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë dhe atë për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, dentistëve dhe arkitektëve.

Hoti, ministrit Pecit: Efektet e punës i ke zero, prodhimi vendor ka rënë

PRISHTINË, 24 SHKURT - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, i ka reaguar ministrit të Bujqësisë, Faton Peci, për të cilin ka thënë se pas thirrjes për rritje të subvencioneve në bujqësi, i njëjti "kishte shkruar një pamflet me plot tallje e cinizëm". Sipas Hotit, faktet tregojnë se efektet e punës së ministrit Peci janë zero, teksa shtoi se sipas të dhënave të Doganës së Kosovës gjatë vitit 2022, krahasuar me vitin 2022, ka pasur rritje të importit të grurit, mishit e qumështit.

Ai ka thënë se rritja enorme e importit të produkteve bujqësore gjatë vitit 2022 është shenjë se prodhimi vendor ka rënë. "Që nga fundi i vitit 2021 e kam theksuar

disa herë, se nëse nuk rritet menjëherë mbështetja për bujqit, rritja e konsiderueshme e çmimit të inpueteve bujqësore (farëra, plehra, pesticide dhe ushqim të kafshëve) do të dëmtojë prodhimin vendor. Dje e kam përsëritur këtë shqetësim pasi çmimet e këtyre inpueteve bujqësore po vazhdojnë të rriten. Ministri i Bujqësisë, në vend se të sqarojë se çfarë po bën për ta zbutur krizën për bujqit, kishte shkruar një pamflet me plot tallje e cinizëm. Faktet tregojnë se efektet e punës së tij janë zero", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Ai ka theksuar se sipas të dhënave nga Dogana e Kosovës, gjatë vitit 2022 krahasuar me vitin 2021:



Importi i llojeve të ndryshme të grurit është rritur me 63 për qind (2021 - 22.7 milionë euro, 2022 - 36.9 milionë euro). Importi i llojeve të ndryshme të mishit

është rritur me 51 për qind (2021 - 82.5 milionë euro, 2022 - 124.5 milionë euro). Importi i gjedheve për therje është rritur me 42 për qind (2021 - 45.2 milionë euro,

2022 - 64.2 milionë euro). Importi i qumështit dhe produkteve të qumështit është rritur me 32 për qind (2021 - 56.8 milionë euro, 2022 - 75.2 milionë euro). "Kjo rritje është tepër e madhe pavarësisht rritjes së inflacionit. Nuk ka gjasa që në Kosovë më 2022 të jetë rritur kaq shumë konsumi i qumështit, grurit apo mishit. Kështu që, këto shifra tregojnë se ka rënë prodhimi vendor, dhe se konsumi është plotësuar nga rritja e importit. Le t'ia sqarojë dikush ministrit të nderuar këto të dhëna. Në ditët e ardhshme do të publikohen edhe të dhëna të tjera për ta demaskuar mashtrimin dhe dështimin e kësaj qeverisjeje", ka shkruar Hoti.

Turqia mbështet anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe në NATO

PRISHINË, 24 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premtën në takim ambasadorin e ri të Republikës së Turqisë në Kosovë, Sabri Tunç Angli. Me këtë rast, kryetari Konjufca uroi ambasadorin Angli për detyrën e re dhe vuri në dukje se marrëdhëniet në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë janë shumë të mira e se ato bazohen në miqësi të kamotshme, partneritet strategjik dhe

respekt të ndërsjellë. Gjithashtu, i shprehu ngushëllime për viktimat e tërmeteve që goditën Turqinë, duke theksuar se populli i Kosovës qëndron pranë popullit turk në këto ditë të vështira. Kryetari i Kuvendit vlerësoi lart mbështetjen e vazhdueshme që ky vend mik i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë shtetit të Kosovës. Ambasadori Angli e falënderoi kryetarin e Kuvendit për pritjen,

njëherësh ritheksoi vazhdimin e përkrahjes së Turqisë për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe në NATO, por edhe në institucione dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë. Konjufca dhe ambasadori Angli shprehën gatishmërinë për shtimin e bashkëpunimit të gjithanshëm dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë.



Rasti i Martin Berishajt, Tahiri: Kryelajm në Slloveni, Osmani, Kurti e Gërvalla po e mbrojnë



PRISHINË, 24 SHKURT - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, sërish i është kthyer rastit të ambasadorit Martin Berishaj lidhur me pretendimet për "një aferë financiare që është përfshirë dhe tregtimin e energjisë me kompaninë GEN-I me seli në Beograd".

Tahiri në një postim në "Facebook" ka shkruar se mbrojtja që pushteti ia ka bërë dhe po ia bën Martin Berishajt është dëshmi se këta pushtetarë janë

thellësisht të përfshirë si hisedarë në këtë aferë. "Afera e Martin Berishajt, kryelajm në Slloveni dhe mediet rajonale, e 'çuditërisht' krejt e pa vërejtur nga presidentja Osmani, kryeministri Kurti e ministrja Gërvalla. Mbrojtja që pushteti ia ka bërë dhe po ia bën Martin Berishajt, është dëshmi në vetvete se këta pushtetarë janë thellësisht të përfshirë si hisedarë në këtë aferë", ka shkruar Tahiri. Ndërkaq të enjten deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Driton Selmanaj, ka

paralajmëruar se do ta padisë ambasadorin e Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, për deklarim të rrejshëm. Sipas Selmanajt, ambasadori ka gënjyer nën betim gjatë raportimit në Komisionin Hetimor Hetimor për Energjinë në nëntor të vitit të kaluar, ku kryetar është Selmanaj. Drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, ka adresuar kritika ndaj Qeverisë së Kosovës për mosshkarkimin e ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj.

Duke iu referuar se Berishaj është kryelajm në televizionin publik në Slloveni, sipas Miftarajt, edhe nëse akuzat ndaj ambasadorit hidhen poshtë, ai prapëseprapë nuk do të duhet të vazhdonte të ishte në këtë post. "Ambasadori Berishaj, kryelajm në televizionin publik në Slloveni, sigurisht jo për ndonjë veprë fisnike ose që promovon ndonjë interes për Republikën e Kosovës. Edhe sikur i njëjti të jetë i pastër si loti në aspektin penal dhe krejt çka ka dalë në publik të jetë trillim, një qeveri që promovon

luftën kundër korrupsionit, qeverisje me integritet, me duar të pastra, i njëjti nuk do të duhej as edhe një ditë më shumë të ishte ambasador. Një shtet normal nuk duron raste të tilla në pozita të ambasadorit", ka shkruar Miftaraj në "Facebook".

Ai ka thënë se dorëheqja do të duhej të ishte hapi i parë. "Nëse s'ka dorëheqje, atëherë shkarkim! Por për këtë duhet lidhshmëri që ka parime dhe që e do shtetin më shumë se Martinin", ka shkruar Ehat Miftaraj.

Aktakuzë kundër 10 zyrtarëve komunalë dhe një gjeodeti në Pejë

PEJË, 24 SHKURT - Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë ndaj 10 zyrtarëve të kësaj komune dhe një gjeodeti. Ata dyshohet se kanë kryer veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe konfliktit të interesit. Sipas prokurorisë,

hetimet në lidhje me rastin kanë zgjatur pothuajse dy vjet, teksa bëhet me dije se katër nga personat ndaj të cilëve janë ngritur aktakuzat janë drejtorë komunalë, dy udhëheqës të sektorëve të drejtorive përkatëse, dy inspektorë të ndërtimit, një zyrtar gjeodet dhe një

gjeodet i licencuar pranë Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Më tutje është bërë me dije se mbi 11 personat në fjalë rëndojnë 21 vepra të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, ndërsa dy janë cilësuar si vepra penale të konfliktit të interesit.



BE-ja i jep Kosovës 75 milionë euro ndihmë për përballje me krizën energjetike



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 SHKURT - Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog dhe zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Bislimi, nënshkruan të premten në Prishtinë një marrëveshje financimi që do t'i mundësojë BE-së t'ia transferojë Kosovës 75 milionë euro ndihmë financiare të drejtpërdrejtë dhe t'u ndihmojë qytetarëve dhe bizneseve të përballen me krizën energjetike.

75 milionë euro është kësti i parë i parave që Kosova do t'i marrë nga pakjoja e BE-së për mbështetjen për energji për Ballkanin Perëndimor në vlerë prej 1 miliard eurosh, të krijuar nga BE-ja dhe shtetet anëtare të saj për t'i ndihmuar rajonit që ta kapërcejë krizën energjetike dhe rritjen e madhe të çmimeve të energjisë që i ka shkaktuar pushtimi i plotë, i pajustificuar dhe i paprovokuar i Rusisë ndaj Ukrainës.

E tërë pakjoja do të dorëzohet në

dy pjesë, nga 500 milionë euro secila, ku e para dhe e menjëhershme do të fokusohet në ofrimin e mbështetjes së drejtpërdrejtë për familjet dhe bizneset më të prekura, ndërsa e dyta në tranzicionin e rajonit drejt energjisë së pastër dhe uljen e varësisë nga lëndët djegëse fosile të Rusisë. "Pushtimi i plotë, i paprovokuar dhe i pajustificuar i Rusisë ndaj Ukrainës, ka ndikuar në tërë botën, duke shkaktuar krizë energjetike dhe ushqimore. Efektet e këtyre krizave i kanë ndër të shumti ekonomitë më të cenueshme, ndërsa BE-ja ka ndërhyrë që ta mbështesë Ukrainën që t'i shmangët pushtimit, por edhe t'u ndihmojë partnerëve të saj që të përballen me krizat", ka thënë ambasadori Szunyog, duke shtuar se BE-ja ka qëndruar pranë Ukrainës që nga fillimi i pushtimit dhe e ka përfshirë Ballkanin Perëndimor në veprimet e saj për t'u ndihmuar shteteve anëtare të përballen me krizën, duke përfshirë planin REPowerEU.

"Mbështetja financiare e ofruar përmes Pakos për mbështetjen për energji të BE-së vjen si shtesë dhe synon t'i mbështesë drejtpërsëdrejti njerëzit dhe bizneset në Kosovë", ka shtuar Szunyog.

Nga 75 milionë euro që BE-ja po i transferon tani në Kosovë, një e treta ose 25 milionë euro do të shkojnë për subvencionimin e faturave të energjisë dhe metodave të ngrohjes alternative, si druri dhe peleti, për rreth 200 000 familje, duke përfshirë pensionistët, nënat vetëushqyese, mbajtësit e skemave sociale dhe njerëzit dhe familjet e marginalizuara. 15 milionë euro do të shkojnë për motivimin e publikut për ta kursyer energjinë, duke iu ofruar familjeve subvencione për faturat e energjisë të barabarta me shumatat që ata i kanë kursyer krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo masë do të zbatohet për periudhën janar-prill 2023 dhe nga ajo pritet të përfitojnë rreth 160 000 familje.

35 milionë euro të mbetura do

të përdoren për t'u ndihmuar familjeve dhe ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), që ta rritin eficiencën e energjisë. Rreth 12 000 familje që banojnë në shtëpi private apo banesa në objektet e strehimit social do të mbështeten me përmirësim të termoizolimit (fasadave, dritareve dhe dyerve), ndërsa 10 000 familje të tjera do të mbështeten me blerje të pajisjeve eficiente. Rreth 1 000 NMVM do të mbështeten për të blerë dhe instaluar sisteme të ngrohjes me energji eficiente dhe burime të ripërtëritshme të energjisë, siç janë panelet diellore fotovoltaike ose termike. "Fondet e ofruara do të përdoren nga Qeveria e Kosovës për ta vazhduar zbatimin e masave të planifikuara për zvogëlimin e ndikimit socio-ekonomik të krizës energjetike te qytetarët tanë. Kjo është hera e parë në kuadër të përfitimit nga fondet e IPA-s që BE-ja i ofron të gjitha fondet e programit vjetor si mjete që derdhen drejtpërsëdrejti në

buxhetin e vendit dhe kjo është pikërisht pas kërkesës sonë si Kosovë e orientuar kah Bashkimi Evropian", ka theksuar zëvendëskryeministri Bislimi, duke shtuar se mbështetja e BE-së prej 75 milionë eurosh e plotëson skemën e qeverisë për mbështetje të energjisë. "Dua ta shpreh mirënjohjen time për Bashkimin Evropian për mbështetjen dhe besimin e tij në vendin tonë. Ky besim na inkurajon të punojmë edhe më shumë dhe ta vazhdojmë ngritjen e kapaciteteve institucionale në të gjitha institucionet e linjës", ka theksuar Bislimi.

BE-ja mbetet ofruesja më e madhe e ndihmës financiare për Kosovën, me 1.2 miliard euro të ofruara përmes Instrumentit të Asistencës së Para Anëtarësimit (IPA) I dhe II, nga viti 2007 deri në vitin 2022. Ndihmë financiare e mëtejshme tani po ofrohet përmes IPA III.

BE-ja është, po ashtu, partnerja më e madhe tregtare e Kosovës.

Kosova dhe Mali i Zi e shohin të rëndësishëm ndërtimin e rrugëve Pejë - Rozhajë dhe Deçan - Plavë

PRISHTINË, 24 SHKURT - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi dhe ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, u pritën në takim në Podgoricë nga zëvendëskryeministri i Malit të Zi, Ervin Ibrahimovic. Palët biseduan për projekte të përbashkëta, për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ekonomik, për tejkalimin e barrierave ekzistuese dhe për lehtësimin e procedurave

administrative. Zëvendëskryeministri Bislimi foli rreth procesit të integritimit evropian pas aplikimit për anëtarësim në muajin dhjetor, duke vlerësuar mbështetjen e Malit të Zi për rrugëtimin evropian të Kosovës. Nga Mali i Zi mund të përfitojmë bashkërisht nga përvoja në proces dhe të ecim drejt objektivit të përbashkët të aderimit në familjen evropiane. Kosova dhe Mali i Zi përkasin në Bashkimin Evropian.



Në takim u bisedua edhe në lidhje me projektet infrastrukturore ku ministri Aliu shprehu se do të punojnë me intensitet për të avancuar dhe çuar para ndërtimin e rrugëve Pejë - Rozhajë dhe ndërtimin e rrugës Deçan - Plavë, projekte këto të shumëpritura për qytetarët e të dyja vendeve, me rëndësi madhore për infrastrukturën dhe ekonominë, projekte kombëtare që lehtësojnë ndërlidhjen e qytetarëve të Kosovës me Malin e Zi.

Niveli i deteve do të rritet më shumë nga sa pritet?

Nëse nuk arrijmë të ndalojmë rritjen e temperaturës globale nën 1.8°C, do të kemi humbje të pakthyeshme në shtresat e akullit dhe niveli i detit do të rritet më shpejt



Një studim i botuar në Nature Communications nga një grup ndërkombëtar shkencëtarësh tregon se një humbje e pakthyeshme e shtresave të akullit të Antarktidës Perëndimore dhe Grenlandës, dhe një përshpejtim respektiv i shpejtë në ngritjen e nivelit të detit, mund të jenë të pashmangshme nëse nuk arrijmë të bllokojmë rritjen e temperaturës globale nën 1.8 °C krahasuar me nivelet para-industriale.

MOSDAKORDËSI

Popullsité bregdetare anembanë botës tashmë duhet të përgatiten për reagime ndaj rritjes së nivelit të detit, por planifikimi i tyre për të parandaluar përmbytjet dhe dëmtimet e tjera është jashtëzakonisht i vështirë për t'u

zbatuar pasi parashikimet më të fundit të modelit klimatik të paraqitur në Raportin e 6-të të Vlerësimit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) nuk kanë dakordësi, se sa shpejt shtresat kryesore të akullit do t'i përgjigjen ngrohjes globale, duke bërë që politikanët të hezitohen mbi atë çfarë duhet të bëjnë.

Shkrirja e shtresave të akullit është potencialisht kontribuesi më i madh në ndryshimin e nivelit të detit, megjithëse ai është historikisht më i vështirë për t'u parashikuar, sepse fizika që rregullon sjelljen e tyre është jashtëzakonisht komplekse. "Modelet kompjuterike që simulojnë dinamikën e shtresave të akullit në Grenlandë dhe Antarktidë shpesh nuk marrin parasysh se shkrirja e shtresave të akullit ndikon thellësisht në

proceset oqeanike, të cilat, nga ana tjetër, ndikojnë në shtresën e akullit dhe atmosferën."

MODELI I KOMPJUTERIZUAR

Duke përdorur për herë të parë një model të ri kompjuterik që kombinon rrjedhat midis shtresave të akullit, ajsbergëve, oqeanit dhe atmosferës, ekipi i studiuesve të klimës ka zbuluar se pasojat e tmerrshme të rritjes së nivelit të detit mund të parandalohen vetëm nëse bota arrin emetimet zero karbon deri në vitin 2060.

"Nëse e humbasim këtë objektiv," thotë Axel Timmermann, bashkëautor i studimit dhe drejtor i Qendrës IBS për Fizikën Klimatike, "shtresat e akullit mund të shpërbëhen dhe të shkrihen me

një ritëm të përshpejtuar. Kështu thonë modelet. Nëse nuk ndërmarrim asnjë veprim, tërheqja e shtresave të akullit do të rrisë nivelin e detit me të paktën 100 centimetra brenda 130 viteve të ardhshme. Kjo do t'i shtojë kontributeve të tjera, siç është zgjerimi termik i ujit të oqeanit."

PAPARASHIKUESHMEËRIA

Shtresat e akullit i përgjigjen ngrohjes atmosferike dhe oqeanike në mënyra të vonuara dhe shpesh të paparashikueshme. Dhe përveç kësaj, ndonjëherë ka interpretime të sjelljes së tyre që nuk janë plotësisht të sakta. Studimet e ndryshme kishin fajësuar veprimin e oqeanëve në shkrirjen e kapakëve të akullit nga poshtë tyre, në një formë erozioni nga poshtë lart. "Megjithatë,

simulimet tona thonë se kjo ka një vlerë të pjesshme, ndërsa veprimi i shkrirjes mund të rrjedhë mbi të gjitha nga qarkullimi atmosferik i cili do të ngrohet në dekadat e ardhshme", vijon shkencëtari.

ATËHERË?

Prandaj është e nevojshme të zhvillohen modele të reja të sistemit të tokës që lidhin gjithçka që rrotullohet rreth ndryshimit të klimës dhe jo vetëm elementeve individuale, me fjalë të tjera, argumentojnë këta studiues, është e nevojshme që superkompjuterët të hyjnë në lojë për të përpunuar ndërveprimet komplekse, të cilat sidomos në pole, krijohen midis hapësirave akullnajore dhe atmosferës. / focus – bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Llapi përgjigjet për dyshimet për kurdisje: Nuk kemi shqetësim rreth pretendimeve të pabaza dhe tendencioze

Llapi i Podujevës është përmendur në raportimet e medieve franceze për manipulimin e katër ndeshjeve, mirëpo klubi llapjan ka mohuar se është përfshirë në manipulime të tilla dhe nuk ndihet i shqetësuar rreth akuzave në fjalë. Ndërsa Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se do të koordinohet me UEFA-n dhe organet e tjera ndërkombëtare për hetimin e këtij rasti

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 SHKURT - Të enjten mediet franceze "Le Figaro" dhe "Le Parisien" raportuan se në futbollin e Kosovës janë kurdisur ndeshje, derisa nëntë persona janë arrestuar. Sipas medieve në fjalë, Llapi nga Podujeva është i përfshirë në kurdisjen e katër ndeshjeve. Pas këtyre akuzave ka reaguar skuadra e Llapit nëpërmjet një njoftimi për medie, ku ka hedhur poshtë të gjitha akuzat. "Ftojme gjithë tifozët llapjanë që mos të bien pre e këtyre shkrimeve tendencioze dhe qëllimkëqija që

kanë për qëllim ta njollosin emrin e klubeve të caktuara dhe vetë Superligës. KF Llapi ju njofton se nuk ka asnjë informata të vetme të konfirmuar nga organet e hetuesisë rreth këtyre pretendimeve siç janë publikuar nga portalet dhe gazetatat e ndryshme. Ne si klub nuk kemi as edhe më të voglin shqetësim rreth këtyre pretendimeve të pabaza dhe tendencioze. I ftojme edhe tifozët që mos të shqetësohen sepse nuk ka asgjë të vërtetë në këtë drejtim. Jemi të fokusuar 100 % vetëm për ndeshjen me Prishtinën dhe nuk ka forcë që na ndal drejt arritjes



së objektivave tona", thuhet në reagimin e Llapit. Lidhur me rastin në fjalë, të premtën edhe Komiteti i Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës ka mbajtur mbledhje, në të cilën ka shqyrtuar raportimet lidhur me pretendimet në mediet lokale dhe ndërkombëtare për parregullsi në ndeshje të Superligës së Kosovës. KE ka ndërmarrë menjëherë masat e nevojshme për ta hulumtuar rastin dhe për ta adresuar atë në mënyrë urgjente tek organet

kompetente. "FFK, së bashku me autoritetet në Kosovë, do të koordinohet me UEFA-n dhe organet e tjera ndërkombëtare për hetimin e këtij rasti dhe varësisht prej rezultateve të hetimit, organet tona disiplinore do t'i ndërmarrin masat e nevojshme ndaj klubeve apo individëve të përfshirë në parregullsitë eventuale", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës. FFK-ja është plotësisht e gatshme të bashkëpunojmë me çdo autoritet të Republikës së

Kosovës dhe me ato ndërkombëtare në mënyrë që të ruhet integriteti i futbollit dhe i sportit të Kosovës në përgjithësi. Ndërsa Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), më saktë Këshilli për Sport i Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive, ka dalë me komunikatë zyrtare: "Këshilli Kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, ashtu siç e ka njoftuar opinionin edhe me prononcimet e mëhershme, ka kërkuar dhe do të angazhohet në vazhdimësi që çdo dyshim i ngritur për kurdisje të ndeshjeve sportive të hetohet nga organet përkatëse shtetërore dhe përgjegjësit të dalin para ligjit. Me kërkesën e Këshillit për Sport, prokuroria e shtetit, me mbështetje të Policisë së Kosovës, është duke u marrë me trajtimin e çdo dyshimi të ngritur për kurdisje të ndeshjeve sportive, duke përfshirë edhe rastin e publikuar në medie".

Rikthehet në aksion Superliga e basketbollit

PRISHTINË, 24 SHKURT - Pas ndeshjeve fantastike në Final 8 Kupën e Kosovës, Prince Caffè Superliga rikthehet me xhiron e 23-të apo fazën e fundit të garave të rregullta, ku do të vendoset gjithçka. Sfida e parë zhvillohet ndërmjet Rahovecit dhe Vëllaznimit. Vreshtarët janë në vendin e fundit me dy fitore e 20 humbje, ndërsa kuqezinjtë janë në vendin e gjashtë me tetë fitore e 14 humbje. Për të dyja skuadrat kjo sfidë është shumë e vlefshme dhe do të garojnë deri në fund për fitore.



Peja me trajnerin e ri izraelit Rami Hadar do të presë Ponte Prizrenin. "Verdhezinjtë" janë në vendin e tretë me 15 fitore e shtatë humbje, ndërsa prizrenasit kanë shtatë fitore e 15 humbje. Takimi i fundit i kësaj xhiroje është ndërmjet dy skuadrave me traditë në

SUPERLIGA - Java 23

Të shtunën takohen:
17:00 Rahoveci - Vëllaznimi
19:00 Peja - Ponte Prizreni

Të dielën takohen:
17:00 Bashkimi - Trepça
(Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli zhvillohet më vonë)

basketbollin e Kosovës, Bashkimit dhe Trepçës. Prizrenasit kanë dhjetë fitore e 12 humbje, kurse mitrovicasit 13 fitore e nëntë humbje, duke e bërë këtë përballje shumë interesante. Sigal Prishtina - Golden Eagle Ylli zhvillohet në një termin tjetër.

Kryendeshja zhvillohet në 'Zahir Pajaziti'

Prishtinë, 24 shkurt - Ndeshjet e javës së 22-të në Superligën e Kosovës në futboll zhvillohen në fundjavë. Ndeshja kryesore e kësaj xhiroje zhvillohet të dielën në stadiumin "Zahir Pajaziti". Përballen Llapi dhe Prishtina, duel ky që parashikohet të jetë interesante për shkak të rivalitetit të madh të këtyre skuadrave, por edhe për pikët që i kërkojnë me ngulmë. Llapi i ka fituar në të tria ndeshjet në sezonin pranveror, kurse Prishtina në tri takimet e para në Superligë ka pësuar humbje. Ballafaqim interesante pritet të jetë edhe në duelin Ferizaj - Drita, ndeshje kjo që luhet të shtunën. Të dyja skuadrat po tregojnë formë të mirë dhe kanë ambicie të kundërta. Ferizaj e kërkon mbijetesën, ndërsa Drita titullin. Malisheva - Drenica është një tjetër ndeshje që luhet të shtunën. Të dyja



skuadrat po 'luftojnë' me të gjitha forcat në garën për t'i ikur zonës së rrezikshme, andaj të dyja skuadrat më të gjitha forcat do të hyjnë në këtë duel me ambicie për të fituar. Lideri i tabelës, Ballkani, para tifozëve të vet kërkon fitoren e radhës kundër Dukagjinit, ndeshje kjo që luhet të dielën pasdite, derisa të njëjtën ditë luhet edhe dueli Gjilani - Trepça '89. Të gjitha ndeshjet e javës së 22 transmetohen drejtpërdrejt në Radio Kosova.

SUPERLIGA - Java e 22-të

Të shtunën takohen:
13:00 Ferizaj - Drita
13:00 Malisheva - Drenica

Të dielën takohen:
13:00 Llapi - Prishtina
13:00 Gjilani - Trepça '89
13:00 Ballkani - Dukagjini

Liga e Evropës, short me fat për Unitedin dhe Juventusin

Nyon, 24 shkurt - Pas kualifikimit një natë më parë, skuadrat e Ligës së Evropës kanë mësuar shortin e fazës për 1/8 finale të këtij kompeticioni. Të pashmangshme duelet e forta të skuadrave

pretendente. Kështu, Manchester Unitedi do të përballet me Betisin, ndërsa Juventusin duket me fat teksa "peshkoi" gjermanët e Freiburgut. Ndeshjet e para do të luhen më 9 mars, ndërsa ato të

kthimit më 17 mars. Lideri i Premierligës, Arsenali, do të përballet me Sportingun, kurse Roma me Real Sociedadin. Çiftet e 1/8-së: Union Berlin-Union Saint Gilloise, Sevilla-

Fenerbahçe, Juventus-Freiburg, Leverkusen-Ferencvárosi, Sporting-Arsenal, Manchester United-Real Betis, Roma-Real Sociedad, Shakhtar Donetsk-Feyenoord.



Përballje interesante në Ligën e Konferencës

NYON, 24 SHKURT - Në Nyon të Zvicrës janë mësuar çiftet për fazën e 1/8-tës në Ligën e Konferencës. Gara e tretë evropiane për klube për nga rëndësia ka hyrë në një fazë të nxehtë pasi kanë mbetur vetëm

edhe 16 skuadra që synojnë trofeun. Ndeshja më interesante padyshim se do të jetë ajo në mes të Anderlechtit dhe Villarrealit. Takime të tjera interesante pritet të jenë edhe ato në mes të Fiorentina-

Sivasspor dhe Lazio-AZ Alkmaar. Finalja e madhe e Ligës së Konferencës është paraparë të zhvillohet më 7 qershor në "Eden Arena" të Pragës në Çeki. Çiftet e 1/8-s në Ligën e Konferencës: AEK Larnaca-West

Ham United, Fiorentina-Sivasspor, Lazio-AZ Alkmaar, Lech Poznan-Djurgarden, Basel-Slovan Bratislava, Sheriff Tiraspol-Nice, Anderlecht-Villarreal, Gent-Istanbul Basaksehir.



Albion Rrahmani sërish 'Ylli i javës' në Superligë

SUHAREKË, 24 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë të japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 21-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Ballkani, Albion Rrahmani.

Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit, në përbërje: Shyqeri Salihu, Bujar Asllani dhe Berat Berisha.

Sulmuesi i portokallezjve po kalon në formë të shkëlqyeshme në fillim të stinorit pranveror dhe ka qenë përcaktues në tri fitoret radhazi të kampionit në fuqi. Ai e fitoi këtë çmim edhe në javën e 19, kur shënoi "hat-trick". Ndërkaq, këtë mesjavë Albion D. Rrahmani, me golin e tij në minutën e 88, e ndihmoi Ballkanin të realizojë fitore ndaj Trepcës '89 në Mitrovicë (1:0). "I kam premtuar vetes që do të jap maksimumin



çdo xhiro për të ndihmuar ekipin drejt objektivit të mbrojtjes së titullit dhe më gëzon fakti që po rikthehem për ta marr këtë shpërblim si më i miri i javës. Gjithmonë them se të shpallësh më i miri i javës nuk është vetëm për meritë të punës time, por këtu më ndihmojnë shumë edhe

bashkëlojtarët dhe shtabi teknik të cilëve u jam mirënjohës. Do ta vazhdoj punën time nga ndeshja në ndeshje dhe shpresoj që në fund të jem golashënuesi më i mirë në Superligë dhe Ballkani të jetë sërish kampion", ka theksuar Rrahmani për faqen zyrtare të FFK-së.

Lakersat mundin kampionët, Bostoni buzëqesh në shtesë

LOS ANXHELOS, 24 SHKURT - Skuadra kampione e Golden States është mposhtur me rezultat 124-111 nga lakersat, dy skuadra që synojnë një vend në "play-off" në Perëndim, ndeshje e dominuar nga lakersat, ku tetë lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Beasley me 25 pikë ishte shënuesi më i mirë për lakersat, ndërkohë që 68 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Fitoi edhe Philadelphia, që falë 27 pikëve e 19 reboundeve të Joel Embiidit, mundi me rezultat 110-105 Memphisin. Denveri ruan



kreun në Konferencën e Perëndimit pas fitores 115-109 në fushën e Clevelandit. Tjetër ndeshje e mirë për Nikola Jokiqin, autor i një "triple double", me 24 pikë, 18 rebounde e 13 asistime. Pas kohës shtesë fiton Bostoni, që mbron kreun në Lindje. Ekipi i Celticsit e mposhti me shifrat 142-138 Indianan. Tatum realizoi 31 pikë e 12 rebounde, Brown 30 pikë e 11 rebounde, një dyshe që bëri

diferencën në fushë për miqtë. Ekipi i Dallasit mposhti me rezultat 142-116 San Antonion, sfidë ku tetë basketbollistë të Mavericksit realizuan mbi 10 pikë. Luka Doniqiqi realizoi 28 pikë e 10 asistime, ndërsa Irvingu realizoi 23 pikë. Orlando, falë 21 pikëve të Wagnerit, mposhti me rezultat 108-106 Detroitin, ndërsa Toronto mundi me rezultat 115-110 New Orleansin, ndeshje ku u dallua Siakami me 26 pikë.

REZULTATET

Cleveland - Denver	109-115
Indiana - Boston	138-142
Orlando - Detroit	108-106
Philadelphia - Memphis	110-105
Toronto - New Orleans	115-110
Dallas - San Antonio	142-116
Utah Jazz - Oklahoma	120-119
Lakers - Golden State	124-111
Sacramento - Portland	133-116

Xavi: Jemi të zhgënjyer, tani të përqendrohemi në kampionat dhe Kupë

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, e ka quajtur zhgënjim eliminimin nga Liga e Evropës. Ai ka thënë se

Barça duhet të përqendrohet në kampionat dhe Kupën e Mbretit. "Ishte një tjetër zhgënjim për ne. Më vjen keq

pasi luajtëm një ndeshje të hapur. Ndjesia është se jemi më mirë se një vit më parë, por jemi përballur me rivalë

të mëdhenj. E vetmja gjë pozitive është se tani do të jemi të përqendruar totalisht në kampionat dhe në Kupën

e Mbretit. Duhet të jemi të përqendruar në të dy kompeticionet", ka thënë Xavi.

SHKURT

Chelsea ofron 18 milionë euro për Zidanen

Pasi vendosi rekord në afatin kalimtar të janarit, duke shpenzuar 360 milionë euro dhe 600 milionë në total, nëse llogaritim edhe blerjet e bëra në verën e kaluar (18 lojtarë në total), pronari i ri i Chelsea, Tod Boehli, nuk ka ndër mend të ndalet me kaq. Në pritje për të kuptuar se si do të përfundojë ky sezon, miliarderi amerikan po mendon për të ardhshmin, ku natyrisht nuk do të jetë kaq tolerant me rezultatet. Ideja e tij është gjetja e një trajneri special që të mund të stërvitë yjet e tij dhe të ndërtojë një skuadër konkurruese. Dhe zgjedhja është Zinedine Zidane. Fakti që francezi është ende në kërkim të një bankine, Chelsea ka nisur joshjen, duke i bërë ofertën e parë, 18 milionë euro neto në sezon, plus dorë të lirë në merkaton e kësaj vere.

Ten Hag: Dëshmuam se mund të fitojmë ndeshje të mëdha

Manchester Unitedi e eliminoi Barcelonën nga Liga e Evropës, pasi e mposhti të enjten me rezultat 2-1, kurse ndeshja e parë në "Camp Nou" kishte përfunduar 2-2. Trajneri i Unitedit, Erik Ten Hag, ka thënë se skuadra e tij dëshmoi se mund të mposhtë çdo skuadër të madhe. "Ishte një paraqitje fantastike që na jep besim se mund të fitojmë ndeshje të mëdha. Kemi shumë personalitet si skuadër", ka thënë Ten Hag.

Dy lojtarë të Realit humbin ndeshjen kthyesë ndaj Liverpoolit

Real Madridi e fitoi ndeshjen e parë kundër Liverpoolit (2-5), por ka marrë lajme të këqija nga infermeria. "Los Blancos" në faqen zyrtare ka njoftuar se Reali do të duhet të bëjë pa David Alaban dhe Rodrygon në ndeshjen e kthimit. Gjithsesi, trajneri Carlo Ancelotti ka një grup të pasur lojtarësh dhe zëvendësimi nuk do të jetë aspak një problem për të.

Quartararo: Motori i ri është zhgënjyes

Piloti francez i Yamahas, Fabio Quartararo, ka folur për motorin e ri që do të përdorë këtë sezon. Ai ka mbetur i zhgënjyer nga testet e zhvilluara një javë më parë në Sepang, ku u klasifikua në vendet e fundit. "Një ndjesi mikse pas testeve të para. Jam i kënaqur me shpejtësinë që motori ka në pjesën e drejtë dhe mënyrën se si reagon me gomat e përdorura. Pra, ka një ritëm të mirë. Gjithsesi, me gomat e reja është një zhgënjim, një dështim", ka thënë francezi, kampion bote në MotoGP në vitin 2021. "Nuk e kuptojmë ende pse jemi kaq larg të tjerëve. Duhet të bëjmë një kontroll total para testeve të tjera në Portugali, të kuptojmë se ku është problemi. Provat zyrtare janë të rëndësishme dhe çdo vit kemi gjithnjë e më shumë probleme në këtë drejtim", ka shtuar Quartararo. "Në përgjithësi, në ritmin e përgjithshëm të garës, motori duket mirë, por nëse nuk kualifikohemi në vendet e para, nuk mund të duelojmë për fitore. Madje as për t'u renditur mes 5 më të mirëve, pasi do të humbasim kohë për të gjetur ritmin dhe me parakalime. Duhet të punojmë për xhiron e shpejtë", ka deklaruar Quartararo.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Argjentina Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Fetah Zabelaj B.I. emri Tregtar Auto-Taxi Fetah Zabelaj shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810318792 nrb. 80326394.

- Shpend Kumnova nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII dhe diplomën e Gjmnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Kristian Nikolla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Musa Smajlaj nga Jabllanica KK Gjakovë shpall të pavlefshme certifikatën për muratorë lëshuar nga Q.A.P. Pejë.

- Samir Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Makfire Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " 17 Shkurti " Hatmaxhe.

- Ivica Dimic shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Marigona Musli Mejzinolli shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit AAB Prishtinë drejtimi Psikologji Bachelor me nr. 1640/18.

- Drin Jakurti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Shkelqim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu "Yll Morina" Gjakovë nga kl.I-IX.

- Qëndrim Haziri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Shkelqim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu "Mustafa Bakija" nga kl. I-V Gjakovë.

- Shqipe Mazreku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën diplomën e shm Mjekësisë "Hysni Zajmi".

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues